<sup>4</sup> Kjo deklarate ka si qellim plotësimin e kriterit ligjor që operatori ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent

## Shtojca 12

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;*
- c. *Sigurim oferte, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 3;*
- ç. *Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
- d. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
- dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;*
- e. *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;*
- f. *Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;*
- g. *Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;*
- gj. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### **2.1 Per kapacitetin ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:**

- a) Ofertuesi duhet të tregojë, në objektin e veprimtarisë së tij, se është në gjendje të realizojë objektin e prokurimit;
- b) Sipas përcaktimeve të bëra në pikën 1 “Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit” të kësaj shtojce (Shtojca 12).
- c) Një dokument që vërteton se nuk ka detyrime të pashlyera përtaksat vendore pranë njësisë së qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitet sipas ekstraktit të regjistrimit tregtar, për vitet 2019 dhe 2020. Vërtetimi duhet detyrimisht të jetë përshkruar, ndër të tjera, edhe NIPT-in e subjektit. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga njësia e qeverisjes vendore.

### **2.2 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:**

- a) Operatori ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm. Operatori ekonomik duhet nuk duhet të jetë me humbje për të tre vitet e fundit. Për këtë duhet të paraqes kopje të vërtetuar të pasqyrave financiare për periudhën 2017, 2018 dhe 2019, të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse të konfirmuar nga ky autoritet me nënshkrim dhe vulë në çdo faqe të dokumentit, të shoqëruar me Raport të Ekspertit Kontabël. Nuk është e detyrueshme paraqitja e Raportit të Ekspertit Kontabël për ato subjekte që nuk plotësojnë kushtet ligjore.
- b) Xhiro mesatare e realizuar nga Operatori Ekonomik gjatë tre viteve të fundit 2017, 2018 dhe 2019 duhet të mos jetë më e vogël se 50% vleres se fondit limit të tenderit. Për këtë të paraqitet Vërtetim nga organet Tatimore për xhiron vjetore gjatë tre viteve të fundit.

### **2.3 Për kapacitetin teknik:**

2.3.1 Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

- a) Punë të ngjashme për një kontratë të vetme të së njëjtës natyrë me objektin që prokurohet në një vlerë jo më të vogël se 50% të fondit limit, të realizuar gjatë tri viteve të fundit. dhe/ose

b) Punë të ngjashme ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e vogël se 200% e fondit limit.

Për të vërtetuar pikat a) dhe b) duhet të paraqitet:

- a-Kontratë/kontratata nënshkruar nga palët.
- b-Situacion i përfundimtar të punimeve.
- c-Aktin e kolaudimit të punimeve.
- d-Aktin e marrjes në dorëzim të punimeve nga investitori.
- e-Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës 8.

Plotësimi i njërit prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bënë ofertën të kualifikueshme.

Si referencë për llogaritjen e afateve do të merret data e kolaudimit të objektit.

Për objektet me financime private:

- a.i. *Leje ndertimi.*
- a.ii. *Kontratën e Sipërmarrjes.*
- a.iii. *Situacion përfundimtar të objektit.*
- a.iv. *Aktin e Kolaudimi përfundimtar të objektit.*
- a.v. *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojcës përkatëse, vlerësuar me notën 10 ose e shprehur në fjalë "shumë mirë".*
- a.vi. *Faturen/at tatimore.*

Për objektet me vetëfinancim (nga Operatori Ekonomik):

- a.i. *Leje ndertimi.*
- a.ii. *Situacion përfundimtar të objektit.*
- a.iii. *Aktin e Kolaudimi përfundimtar të objektit.*
- a.iv. *Faturen/at tatimore.*

### **2.3.2 Licenca profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.**

Ofertuesi duhet të jetë i pajisur me licencë profesionale të shoqërisë, me kategoritë:

N.P – 1 D	Punime gërmimi në tokë.
N.P - 2 G	Ndertime civile dhe industriale
N.P – 3 E	Rikonstruksione dhe mirëmbajtje godinash
N.P – 4 F	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, ...
N.P – 5 C	Punime nentokesore ,ura e vepra arti.
N.P. – 6 A	Diga dhe tunele hidroteknike
N.P. - 7 F	Ujesjellesa,gazesjellesa etJ.
N.P. – 8 A	Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë
N.P - 9 B	Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime
N.P – 10 A	Ndërtim i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike
N.P. – 11 C	Ndërtime përN/stacionet, kabinat ...
N.P – 12 C	Punime të inxhinierisë së mjedisit
N.S – 1 C	Punime për prishjen e ndërtimeve
N.S – 2 B	Impiante hidro-sanitare, kuzhina ...
N.S – 3 B	Imiante ngritëse dhe transportuese ...

## Dokumenta Standarde të Tenderit

N.S – 4 F	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to
N.S – 5 B	Impiante të sinjalistikës ndricuese të trafikut
N.S - 6 B	Sinjalistika rrugore jo ndricuese
N.S – 7 B	Barriera dhe mbrojtje rrugore
N.S – 8 C	Ndërtime parafabrikat beton arme ...
N.S – 9 B	Punime strukturore speciale
N.S – 10 C	Shtresa dhe mbistruktura speciale
N.S – 12 B	Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit
N.S – 13 B	Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni
N.S – 14 C	Impiante të brendëshme, elektrikë, telefoni, radiotelefoni, TV, etj.
N.S – 15 A	Pastrimi i ujërave detarë, ...
N.S - 16 B	Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm...
N.S – 17 A	Ndërtimi i impianteve të grumbullimit ...
N.S - 18 B	Punime topogjeodezike
N.S – 19 B	Sisteme kundra zhurmës për infrastrukturë
N.S - 20 A	Shpime gjeologo-inxhinierike,puse e shpime per uje .

Për Operatorët e huaj të bëhet njësimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

### 2.3.3 Ofertuesi duhet të paraqesë certifikatën: Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me:

- Certifikatë ISO 9001-2015 (e vlefshme me auditim vjetor, duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve, në rast bashkimi të OE).
- Certifikatë ISO 14001-2015 (e vlefshme me auditim vjetor, duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve, në rast bashkimi të OE).
- Certifikatë ISO 45001-2018 (e vlefshme me auditim vjetor, duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve, në rast bashkimi të OE).
- Certifikatë PASS 99:2012 (e vlefshme me auditim vjetor, duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve, në rast bashkimi të OE).
- Certifikatë ISO 39001-2012 (e vlefshme me auditim vjetor, duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve, në rast bashkimi të OE).
- Certifikatë ISO 50001-2018 (e vlefshme me auditim vjetor, duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve, në rast bashkimi të OE).
- Certifikatë ISO 27001-2013 (e vlefshme me auditim vjetor, duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve, në rast bashkimi të OE).
- Certifikatë BC SA 8000:2014 (e vlefshme me auditim vjetor, duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve, në rast bashkimi të OE).
- Certifikatë ISO 1452-1:2009 (e vlefshme me auditim vjetor, duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve, në rast bashkimi të OE).
- Certifikatë DS CENTR 115128:2015 (e vlefshme me auditim vjetor, duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve, në rast bashkimi të OE).
- Certifikatë ISO 13331-1-2002 (e vlefshme me auditim vjetor, duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve, në rast bashkimi të OE).
- Certifikatë IRATA/ose ekuivalente e saj për punime në lartësi, të paktën punonjës të certifikuar, ku të jenë të paktën dy inxhinierë të punësuar si drejtues teknik pranë subjektit ofertues.

## Dokumenta Standarde të Tenderit

- 3 (tre) inxhinier të certifikuar për sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit të punëtorëve.

Certifikatat të jenë lëshuar në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara.

2.3,4 Deklaratë e disponueshmërisë së makinerive, sipas shtojcës 9, që nevojiten për ekzekutimin e kontrates;

Nr	LLOJI I MAKINERIVE	DISPONIMI	SASIA
1	Kamion, mbi 18 ton	Në pronësi ose me qira	Copë 3
2	Kamion, mbi 7.5 deri 18 ton	Në pronësi ose me qira	Copë 2
3	Kamion, nga 3.5 deri ne 7.5 ton	Në pronësi ose me qira	Copë 2
4	Kamioncin, deri ne 3.5 ton.	Në pronësi ose me qira	Copë 4
5	Terheqes	Në pronësi ose me qira	Cope 1
6	Rimorkiator per transportin e makinerive	Në pronësi ose me qira	Cope 1
7	Furgon për transportin e punëtorëve	Në pronësi ose me qira	Cope 2
8	Grejder	Në pronësi ose me qira	Cope 2
9	Rrul	Në pronësi ose me qira	Cope 2
10	Rrul për ngjeshje, deri 100 kg	Në pronësi ose me qira	Cope 2
11	Asfaltoshtruese	Në pronësi ose me qira	cope 2
12	Eskavator me goma	Në pronësi ose me qira	cope 2
13	Eskavator me zinxhir	Në pronësi ose me qira	cope 2
14	Skrep/fadrome	Në pronësi ose me qira	Cope2
15	Minieskavator	Në pronësi ose me qira	cope 1
16	Minifadromë	Në pronësi ose me qira	Copë 2
17	Autovinç/kamion me vinç	Në pronësi ose me qira	Copë 2
18	Autobetoniere kantieri	Në pronësi ose me qira	Cope 1
19	Autobetoniere	Në pronësi ose me qira	Cope 4
20	Autopompë/Presë betoni	Në pronësi ose me qira	Cope 1
21	Autobot uji	Në pronësi ose me qira	Cope 2
22	Autofshese	Në pronësi ose me qira	Cope 1
23	Kallëp metalik për betonin	Në pronësi ose me qira	15 m <sup>2</sup>
24	Makineri vijëzimi	Në pronësi ose me qira	Cope 1
25	Tokmak	Në pronësi ose me qira	Cope 1
26	Batipal	Në pronësi ose me qira	Copë 1
27	Pompë suvatimi	Në pronësi ose me qira	Cope 1
28	Betoniere	Në pronësi ose me qira	Cope 10
29	Vibrator betoni	Në pronësi ose me qira	Cope 5
30	Motosaldatriçe	Në pronësi ose me qira	Cope 3
31	Gjenerator	Në pronësi ose me qira	Cope 3
32	Depozita uji nga 1.000 litra deri 8.000 litra	Në pronësi ose me qira	Cope 5
33	Matrapikë	Në pronësi ose me qira	Cope 4
34	Kompresor	Në pronësi ose me qira	Cope 4
35	Vinç	Në pronësi ose me qira	Cope 4
36	Vinç kull (Kollon)	Në pronësi ose me qira	Cope 1
37	Pompe uji	Në pronësi ose me qira	Cope 5

Dokumenta Standarde të Tenderit

38	Pompe presioni	Në pronësi ose me qira	Cope 2
39	Motosharre asfalti	Në pronësi ose me qira	Cope 3
40	Prerese pllakash	Në pronësi ose me qira	Cope 6
41	Korrese bari	Në pronësi ose me qira	Cope 2
42	Armature (derrase ose panele)	Në pronësi ose me qira	1500 m <sup>2</sup>
43	Skelesri ndertimi	Në pronësi ose me qira	1500 m <sup>2</sup>
44	Skeleri suvatimi (te zinguar), sipas standarteve evropiane	Në pronësi ose me qira	500 m <sup>2</sup>
45	Rrjete suvatimi	Në pronësi ose me qira	1500 m <sup>2</sup>
46	Fikese zjarri	Në pronësi ose me qira	Cope 15
47	Kuti e ndihmes se shpejte	Në pronësi ose me qira	Cope 6
48	Kaskë pune sigurie/kapele minatori	Në pronësi ose me qira	Cope 100
49	Pelerina shiu	Në pronësi ose me qira	Cope 30
50	Rrip sigurimi	Në pronësi ose me qira	Cope 30
51	Jelekë fosforeshent	Në pronësi ose me qira	Cope 100
52	Tabela sigurie	Në pronësi ose me qira	Cope 5
53	Prozhektor / ndriçues	Në pronësi ose me qira	Cope 4
54	Transpalet (pirun)	Në pronësi ose me qira	Cope 1
55	Kontenier për stafin	Në pronësi ose me qira	Cope 2
56	Kanello katramaje per ngjitje kartosere	Në pronësi ose me qira	Cope 2
57	Makineri hekurthyese	Në pronësi ose me qira	Cope 2
58	Prerese hekuri	Në pronësi ose me qira	Cope 2
59	Makineri hapje grope (tryel)	Në pronësi ose me qira	Cope 1
60	Sharre druri	Në pronësi ose me qira	Cope 2
61	Aparat saldimi tubo celiku	Në pronësi ose me qira	Cope 2
62	Aparat saldimi tubo plastike	Në pronësi ose me qira	Cope 1
63	Aparat kontrolli saldimi	Në pronësi ose me qira	Cope 1
64	Autobitumatrice / Bot (cisterne) bitumi	Në pronësi ose me qira	Cope 1
65	Krik hidraulik	Në pronësi ose me qira	Cope 1
66	Kompiuter, laptop	Në pronësi ose me qira	Cope 2
67	Matës largësie	Në pronësi ose me qira	Cope 2
68	Meter lazer	Në pronësi ose me qira	Cope 1
69	Makineri hidrombjellje	Në pronësi ose me qira	Cope 1
70	Kufizues shpejtesie	Në pronësi ose me qira	Cope 1
71	Sonde najloni	Në pronësi ose me qira	Cope 5
72	Sonde celiku	Në pronësi ose me qira	Cope 1
73	Pinca terminale	Në pronësi ose me qira	Cope 1
74	Pinca zhveshese teli	Në pronësi ose me qira	Cope 1
75	Çekiç	Në pronësi ose me qira	Cope 10
76	Exagon komplet	Në pronësi ose me qira	Cope 10
77	Fabrikë betoni shoqëruar me dokumente që vërtetojnë pronësinë, planin e vendosjes dhe lejen mjedisore Kodi: III.1.B, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit ose leja mjedisore të lëshuar nga Ministria e Mjedisit.	Në pronësi, qira ose kontratë noteriale furnizimi.	Cope 1
78	Fabrikë asfalti shoqëruar me dokumente që vërtetojnë pronësinë, planin e vendosjes dhe lejen mjedisore Kodi: III.1.B, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit ose	Në pronësi, qira ose kontratë noteriale furnizimi.	Cope 1

## Dokumenta Standarde të Tenderit

	leja mjedisore të lëshuar nga Ministria e Mjedisit		
79	Nyje fraksionimi inertesh	Në pronësi, qira ose kontratë noteriale furnizimi.	Cope 1
80	Xhamë për dyer, dritare. Shoqëruar me katalog.	Prodhuar, tregtuar ose kontratë furnizimi.	Cope 1

a) Makineritë – pajisjet në pronësi të vërtetohen me anë të aktit të pronësisë. Ato të marra me qera të shoqërohen me kontratë noteriale qiraje (ose formë tjetër) si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit. Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet edhe: leje qarkullimi, certifikatë e kontrollit teknik, policën e sigurimit të mjeteve, dhe foto të mjeteve ku të jetë e dukshme edhe targa e mjetit. Në rast se operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurë është i regjistruar në një vënd të huaj, atëherë mjetet dhe makineritë duhet të jenë të vendosura në Republikën e Shqipërisë me rregjim të përkohshëm, e cila vërtetohet nëpërmjet dokumentit hyrës dhe një deklaratë ku të jetë e shënuar saktë adresa e këtyre mjeteve dhe makinerive.

b) Ofertuesi duhet të paraqes një deklaratë me shkrim të administratorit të shoqërisë ku deklaron se të gjitha mjetet e sipërcituara nuk janë në angazhim në asnjë objekt tjetër aponuk janë dhene me qira ne subjekte apo persona te trete dhe nuk jane te deklaruar ne procedurat e shpallura fitues nga autoriteti kontraktor. Deklaratë me shkrim nga administrator i shoqërisë që, Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në cdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve me apo pa paralajmërim paraprak (në rast verifikimi në fjalë do të hartohet një procesverbal që do të nënshkruhet nga përfaqësuesi i AK dhe përfaqësuesi i shoqërisë ofertuese). Në këtë deklaratë ofertuesi duhet të bëjë deklarinimin e adresës së saktë të vendndodhjes së mjeteve, me qëllim verifikimin e tyre. Mosparaqitja në formën e kërkuar përbën kushtë për skualifikim.

c) Për efekt të kryerjes së punimeve në tërësi, ofertuesi duhet të ketë një staf bashkë me punonjës të siguruar mesatar 150 punonjës për periudhën Korrik 2019 – Korrik 2020. Për të vërtetuar këtë ofertuesi të paraqesë vërtetim lëshuar nga organet tatimore dhe listëpagesat te konfirmuara nga administrata tatimore perkatese me nenshkrim dhe vulë. Shkeljet e akteve ligjore apo akteve nënligjore në deklarinimin e listëpagesave për pagën dhe kontributet e punonjësve do të jenë kusht për skualifikim. Të gjithë të punësuarit duhet të jenë të deklaruar në listëpagesat e shoqërisë sipas kushteve të përcaktuar në kontratën e punës.

ç) Subjekti duhet të ketë staf të kualifikuar me inxhinier / specialistë:

- Drejtues teknik inxhinier ndertimi, 2 te punesuar. Kontrate individuale te punes te lidhur para noterit, diplome me certifikate te leshuar nga IQT ose te leshuar nga institucione te akredituara ekuivalente, CV si dhe te figuroje ne listpagesat e shoqerise nga muaji Janar 2017 e ne vazhdim.

- Drejtues teknik inxhinier hidroteknik, 1 te punesuar. Kontrate individuale te punes te lidhur para noterit, diplome me certifikate te leshuar nga IQT ose te leshuar nga institucione te akredituara ekuivalente, CV si dhe te figuroje ne listpagesat e shoqerise nga muaji Janar 2017 e ne vazhdim.

- Drejtues teknik inxhinier mekanik, 1 te punesuar. Kontrate individuale te punes te lidhur para noterit, diplome me certifikate te leshuar nga IQT ose te leshuar nga institucione te akredituara ekuivalente, CV si dhe te figuroje ne listpagesat e shoqerise nga muaji Janar 2017 e ne vazhdim.

- Drejtues teknik inxhinier elektrik, 1 te punesuar. Kontrate individuale te punes te lidhur para noterit, diplome me certifikate te leshuar nga IQT ose te leshuar nga institucione te akredituara ekuivalente, CV, si dhe te figuroje ne listpagesat e shoqerise nga muaji Janar 2017 e ne vazhdim.



## Dokumenta Standarde të Tenderit

- Drejtues teknik inxhinier topograf/gjeodet/markshajer, 1 te punesuar. Kontrate individuale te punes te lidhur para noterit, diplome me certifikate te leshuar nga IQT ose te leshuar nga institucione te akredituara ekuivalente, CV, si dhe te figuroje ne listpagesat e shoqerise nga muaji Janar 2017 e ne vazhdim.
  - Drejtues teknik inxhinier gjeolog, 1 te punesuar. Kontrate individuale te punes te lidhur para noterit, diplome me certifikate te leshuar nga IQT ose te leshuar nga institucione te akredituara ekuivalente, CV, si dhe te figuroje ne listpagesat e shoqerise nga muaji Janar 2017 e ne vazhdim.
  - Drejtues teknik inxhinier mjedisi, 1 te punesuar. Kontrate individuale te punes te lidhur para noterit, diplome me certifikate te leshuar nga IQT ose te leshuar nga institucione te akredituara ekuivalente, CV, si dhe te figuroje ne listpagesat e shoqerise nga muaji Janar 2017 e ne vazhdim.
  - Inxhinier elektronik, 1 te punesuar. Kontrate individuale te punes te lidhur para noterit, diplome (Bachelor), CV, si dhe te figuroje ne listpagesat e shoqerise nga muaji Janar 2017 e ne vazhdim
  - Mjek,1 te punesuar, i cili te jete i pasqyruar ne listpagesat e shoqerise per periudhen Janar 2017 e ne vazhdim, referuar VKM Nr.742, date 6.11.2003 "Per masat e vecanta te sigurimit dhe mbrojtjes se shendetit ne pune", shoqeruar me kontrate noteriale pune, diplome dhelicense. Ne rast bashkimi operatoresh te pakten njeri duhet te plotesoje kete kriter.
  - 2 drejtues teknik, te punesuar te operatorit ekonomik, te jene te certifikuar per ushtrimin e profesionit "Ekspert privat zjarrefikes", per kete duhet te paraqes certifikate per ushtrimin e profesionit.
- d) Drejtuesit teknik te shoqerise duhet te jene te punesuar me kontrate pune me kohe te plote dhe nuk duhet te jete/ne te punesuar ne asnje subjekt tjetër shteteror. Drejtuesit teknik i/te shoqerise nuk duhet te jete/ne te punesuar ne asnje subjekt tjeternprivat ne rolin e drejtuesit teknik. Gjithashtu per drejtuesit teknik duhet te paraqiten mandat pagesat per 6 muajt e fundit, ku vlera e pages se percaktuar ne kontrate te jete e njejte me ate ne mandat pagese. Per kete shoqeria uhet te paraqese nje deklarate nga administratori i shoqerise dhe te deklarroje se autorizon AK per verifikimin e informacionit te dhene. Mosparaqitja ne formen e kerkuar perben kusht per skualifikim.
- dh) Shoqeria duhet te paraqese nje deklarate, nga administratori i shoqerise, ku te percaktoj drejtuesin/t teknik te shoqerisë i/të do te jete/ne i/të pranishem gjate te gjithë kohes qe do te kryhen punime ne objekt. Gjithashtu ne kete deklarate administratori i shoqerise duhet te deklarroje se autorizon AK per verifikimin e informacionit te dheneper drejtuesin teknik. Mosparaqitja ne formen e kerkuar perben kusht per skualifikim.
- e) Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar dhe te pasqyruar ne listpagesat e shoqerise;
- Bojaxhi, shoqëruar me: kontratë pune dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht 3 të punësuar.
  - Elektracist, shoqëruar me: kontratë pune dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht 4 të punësuar.
  - Hidroizolues, shoqëruar me: kontratë pune dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht 2 të punësuar.
  - Hidraulik, shoqëruar me: kontratë pune dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht 3 të punësuar.

## Dokumenta Standarde të Tenderit

- Hekurkthyes, shoqëruar me: kontratë pune dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht 2 të punësuar.
- Karpentjer, shoqëruar me: kontratë pune dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht 3 të punësuar.
- Manovrator për makineritë e rënda, shoqëruar me: kontratë pune dhe leje manovrimi, minimalisht 8 të punësuar.
- Murator, shoqëruar me: kontratë pune dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht 2 të punësuar.
- Specialist ndertimi, shoqëruar me: kontratë pune dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht 2 të punësuar.
- Shofer për kamiona, shoqëruar me : kontrate pune dhe leje drejtimi, minimalisht 6 te punesuar.
- Suvatues, shoqëruar me: kontratë pune dhe me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht 5 të punësuar.
- Teknik ndërtimi, shoqëruar me: kontratë pune, dëftesë (diplomë) dhe me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht 2 të punësuar.
- Specialist dyer dritare, shoqëruar me: kontratë pune dhe me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose të lëshuar nga institucione të akredituara ekuivalente, minimalisht 1 të punësuar.

Stafi teknik i shoqërisë duhet të figurojë në listpagesat për të paktën 6 muajt e fundit me kohe të plote, ku vlera e pagesave në kontratë duhet të jetë e njëjta me atë në listpagese dhe mandat pagesat. Për këtë duhet paraqitur mandat pagesat për të gjithë stafin teknik. Mosparaqitja në formën e kërkuar përben kusht për skualifikim.

ë) Grafiku i punimeve në përputhje me zërat e punës dhe me afatin kohor në dokumentet e tenderit.

Asnjë ofertues nuk mund të marrë pjesë në ofertën e dikujt tjetër për të njëjtën kontratë, në çfarëdo lloji kapaciteti. Pjesëmarrja nga një ofertues në më shumë se një ofertë, tek e tek ose me një ofertues tjetër do të rezultojë në përjashtimin nga procesi i të gjithë ofertave, në të cilat është përfshirë ofertuesi.

Operatorët e huaj ekonomik, duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e **tyre në gjuhën shqipe (si gjuhë e ofertës)**, për të gjithë përmbajtjen e dokumentit, të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe të jënë të **certifikuara “Apostille”**. Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventën e Hagës, datë 5 tetor 1961, “*për heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumentëve zyrtarë të huaja*”, duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrtarë respektive nga vendi i origjinës. (mosparaqitja në këtë formë është kushtë skualifikues).

## Dokumenta Standarde të Tenderit

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

### Shtojca 13

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)*

#### **PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE**

**Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi** të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

#### **KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektivit etj:

Specifikimet Teknike të Materialeve:

Grafiku i Punimeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

**Shtojca 14**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)*

**PREVENTIVAT E PUNIMEVE**

## Shtojca 15

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### **NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>5</sup>**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt  
< **Emri** >

---

<sup>5</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

## Shtojca 16

[ Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data \_\_\_\_\_]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e

## Dokumenta Standarde të Tenderit

*shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]



## Shtojca 17

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_

Dokumenta Standarde të Tenderit

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

---

---

---

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it* \_\_\_\_\_

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_ / Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it* \_\_\_\_\_

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_ / Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

## Shtojca 18

### **KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët – Procedura e Hapur**

#### **Neni 1: Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

#### **Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokures.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

## Dokumenta Standarde të Tenderit

- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontrates. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, “data e fillimit “do të jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në pregatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

### **Neni 5: Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtun ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

### **Neni 6: Prona Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga kontraktori gjatë zbatimit

të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

### **Neni 7: Origjina e Materialeve**

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

### **Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit**

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

### **Neni 9: Komunikimi**

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

### **Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët**

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

### **Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor**

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me perjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

**Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit**

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.
- 12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

**Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet**

- 13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
